



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 255/6 prot.

Tepelenë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr. 7, datë 29.01.2026

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018”Për Strehimin Social”, pika 4/a e VKM nr.362, datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe Urdhërit Nr 09 datë 28.01.2025 për “Ngritjen e grupit të punës për miratimin e vlerës mesatare sipas strukturës së apartamenteve në treg të lirë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

V E N D O S I

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamentave në territorin e Bashkisë Tepelene, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar Leke
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	Muaj	1	7000
2	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	8000
3	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	9000
4	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	11000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Vendimi Këshillit Bashkiak nr.4 datë 30.01.2025 “Për vendosjen e masës së qirase vjetore për banesat sociale me qira në Bashkinë Tepelenë” shfuqizohet.

4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet zyra e strehimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miraturar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 02.02.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

